



Ja cfarë duhet të kemi parasysh përpara intervistës

Për intervistën nevojitet shumë kërkim dhe planifikim.

Përgjithësisht, duhen bërë gjërat e mëposhtme kur përgatiteni për një intervistë:

- Paraprij pyetjet e mundshme dhe përgatit përgjigjet përkatëse.
- Merr në konsideratë se si do të shpjegosh anë problematike të CV-së tënde, si largimi nga një punëdhënës.
- Kontakto referencat e tua, paralajmëroji ata se do të të intervistojnë dhe se ata mund t'i telefonojnë.
- Kuptoje plotësisht rolin për të cilin po aplikon duke e rishikuar përshkrimin e punës dhe shih se çfarë aftësish, interesash dhe përvojash po kërkon punëdhënësi.
- Përgatit pyetje për t'ia drejtuar intervistuesit.
- Lexo uebsjatin e kompanisë, profilet në mediat sociale dhe literaturën kyçe, duke siguruar se je i përgatitur për t'i shpalosur pikëpamjet dhe idetë e tua. Kërko për lajme, trende, konkurrentë, histori dhe mundësi të kompanisë dhe të sektorit të saj të punës.
- Zgjidhe veshjen tënde një natë më parë, fli gjumë të bollshëm dhe shmang konsumimin e tepërt të alkolit.
- Planifiko udhëtimin tënd, duke synuar që të mbërrish dhjetë minuta më herët
- Shmang të vrapuarit dhe djerësitjen dhe nëse është e mundur luftoje edhe nervozizmin.
- Në ditën e intervistës, konsumo një mëngjes të mirë dhe të shëndetshëm dhe shmang kafeinën e tepërt.
- Kërko modelin më profesional të mundshëm të të shkruarit të një CV-je.

Çfarë të marrësh me vete

- Një shishe ujë
- Një hartë rruge, ose të paktën adresën e kompanisë në mënyrë që të mund ta kërkosh në Google Maps në celularin tënd
- Detaje për personin që do kërkosh kur të mbërrish
- Çertifikatën e notave, shembuj të punës tënde, dhe çdo provë tjetër të sukseseve të tua të së shkuarës para
- stilolaps dhe bllok
- Foto ID (p.sh pasaportë ose patentë)
- Përshkrimin e punës dhe specifikimet e personit
- CV-në tënde, letrën e aplikimit dhe ftesën e intervistës
- Celularin tënd

Si të lësh një pështypje të mirë

Zakonisht duhet:

- T'u përgjigjesh pyetjeve në mënyrë të qartë dhe të përmbledhur
- Bëj pyetje të rëndësishme dhe që ngacmojnë mendjen në çastin e duhur, pasi kjo mund të tregojë se je tejet i interesuar për pozicionin dhe se po e dëgjon me të vërtetë intervistuesin
- Mos flit për problemet e tua personale
- Ji sa më entuziast të jetë e mundur
- Sillu me edukatë me çdo staf që takohesh përpara intervistës
- Shfaq një komunikim shenjash pozitiv, flit qartë, buzëqesh vazhdimisht dhe ruaj kontaktin me sy
- Mos përgojo asnjë punëdhënës të mëparshëm
- Bë me vendosmëri shtrëngime duarsh me intervistuesin/intervistuesit përpara dhe pas takimit
- Thekso cilësitë e tua më të mira, përvojat dhe arritjet, bazuar tek aftësitë që ke parë se janë të rëndësishme për kompaninë, dhe nënivizoji ato me shembuj praktikë
- Informoje intervistuesin/intervistuesit se je i gatshëm t'u përgjigjesh edhe pyetjeve të tjera nëse kanë
- Bëj që personaliteti yt të shkëlqejë
- Relaksohu dhe ulu në mënyrë të natyrshme, por pa u shtrirë në karrige dhe pa u mbështetur në tavolinë
- Shfaqiq duart e tua, pasi kjo është një shenjë ndershmërie
- Vishu në stil biznesi në mënyrë të mençur dhe tërheqëse, me këpucë komode dhe të pastra
- Bëj pauzë përpara se t'i përgjigjesh një pyetjeje të vështirë në mënyrë që t'i japësh vetes kohë për t'u menduar, ose të kërkosh që të sqarohet nëse fillimisht nuk je i sigurt se çfarë do të thotë pyetja
- Ta marrësh çdo gjë me perspektivë, duke i kujtuar vetes se gjëja më e keqe që mund të ndodhë është që të mos e fitosh vendin e punës
- Të shkosh në tualet përpara intervistës
- Të marrësh frymë thellë dhe të mos flasësh shumë shpejt
- Të marrësh bllokun me vete, duke shkruar për të nënvizuar shembujt që synon të tregosh
- Të mendosh për gjera pozitive dhe eksperiencat të lumtura përpara se të nisësh intervistën, dhe ta tregosh veten tërësisht në kontroll gjatë intervistës.